



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|--|--------------------------------|--------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Doretuar Punëho/Prodato Received/Delivered | 30.03.2022 | 2 vit qind vjet | |
| Organ /Jedinita Org /Unit | Nr. Prot Br Prot Prot No | Shtojtja Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPM/SHCK | 1702/2022 | | 113 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.122/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca- anëtarë, për shqyrtimin e ankesës me numër A.Nr.122/2022 të datës 14.02.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 29.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.Nr.122/2022 e datës 14.02.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj/Divizioni për Kundërvajtje në vendin e punës “Ndihmëse e Referenteve për Ekzekutime”, e cila me datë 15.10.2021 me numër të protokollit 3652 ka parashtruar kërkesën për pensionim të parakohshëm tek Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe te Administratori i Gjykatës Themelore në Ferizaj, e cila nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj dhe me datë 01.02.2022 me numër të protokollit 356/22 parashtron përsëri kërkesë për njoftim tek Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe te Administratori i Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Ankuesja pasi që nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj me datë 11.02.2022 parashtron ankesë nëpërmjet Postës së Kosovës për Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 14.02.2022 me numër të protokollit 706/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.03.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raporti Specialistik i datës 10.02.2022; Kopja e letër njoftimit; Kërkesa për njoftim e datës 01.02.2022 e parashtruar nga ankuesja; Kërkesa e datës 15.10.2021 e ankueses për pensionim të parakohshëm; E-mail i datës 02.02.2022; 01.02.2022 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e pa lejuar sepse;*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që ankuesja me datë 15.10.2021 me numër të protokollit 3652 ka parashtruar kërkesën për pensionim të parakohshëm tek Kryetari i Gjykatës dhe tw Administratori i Gjykatës Themelore në Ferizaj pasi që nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj ankuesja përsëri parashtron kërkesën me numër të protokollit 356/22 të datës 01.02.2022 për njoftim lidhur me kërkesën e saj të datës 15.10.2021 dhe pasi që ankuesja nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj ankuesja me datë 14.02.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesja ka pasur të drejtë që para parashtrimit të ankesës në Këshill, të parashtronte ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ashtu siç është e përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që: **"2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe 2.2 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës"**, rrjedhimisht ankuesja brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh prej datës së parashtrimit të kërkesës së datës 15.10.2021 me numër të protokollit 3652, ka qenë e obliguar që të parashtronte ankesë fillimisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave duke vepruar në pajtim me nenin 50 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku qartë është e përcaktuar se nëpunësit civil kanë të drejtë mbrojtje përmes procedurave të brendshme nëse mendojnë se me vendimin apo mosveprimin e organit administrativ u janë shkelur të drejtat e tyre nga marrëdhënia e punës, dhe pas vendosjes apo mos vendosjes së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe



të Ankesave të organit të punësimit ankuesja ka pas të drejtë që të parashtoj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbiqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.122/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

